



Prishtinë, 31 mars 2016  
Kodi i ZRRE: V\_802\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenit 14, paragrafi 2, nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenit 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT);
- Vendimin\_V\_798\_2016 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OST/OT;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS);
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut; dhe
- Kërkesën e datës 25 mars 2016 të KOSTT SH.A, drejtuar ZRRE-së për miratimin e ngarkesave të OST/OT.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifrat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) Sh.A për vitin relevant tarifor apo SHTE10 që do të hyjnë në fuqi nga 1 prill 2016.

## ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i, më datë 25 mars 2016 aplikacionin për tarifa dhe ngarkesa të OST/OT;
- o Për vendosjen e tarifave dhe ngarkesave për KOSTT SH.A, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor. Këto dokumente janë:



- Raport Konsultativ – Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 shkurt 2016;
- Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të KOSTT-it , i publikuar më datën 24 shkurt 2016; dhe
- Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016;

II. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Struktura e ngarkesave për KOSTT SH.A, që do të zbatohet nga data 1 prill 2016, përkatësisht në vitin relevant tarifor SHTE10 është dhënë në tabelën e mëposhtme.

GRUPI TARIFOR	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	TARIFA
Prodhimi i Kyçur në Transmision	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.526
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.041
Prodhimi i Kyçur në Distribucion	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.234
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.041
Furnizimi	Tarifa TNUOS 400/220 kV	€/kW	7.464
	Tarifa TNUOS 110 kV	€/kW	14.589
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.473
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.037

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.


V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimin të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.




**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar,

  
Arsim Janova, anëtar,

  
Qemajl Mustafa anëtar,

  
Besim Sejfi anëtar.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.